



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e mjeteve financiare dhe udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejin e pjesëmarrjes së Komunës së Prizrenit-DTZHE në Panairin e Turizmit në Shqipërisë “Tourism Fair Albania -TFA26”, që mbahet në Pallatin e Kongreseve në Tiranë të Republikës së Shqipërisë nga data 11 shkurt 2026 deri me 12 shkurt 2026, si dhe mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë panair dhe pagesa e mëditjeve. Kështu që, i lejohej Komunës së Prizrenit- DTZHE, pjesëmarrja në këtë organizim, si dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes, lejohen mjetet financiare për:
 - 1.1. Pagesën e hapësirës për pjesëmarrje në shumën prej 1500.00 € (njëmijë e pesëqind euro) në emër të Kompanisë “Iceberg Exhibitions”.
 - 1.2. Mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, të ushqimit dhe transportit për stafin pjesëmarrës të DTZHE-së në këtë panair,
 2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 10 shkurt 2026 dhe kthimi me 12 shkurt 2026.
 3. Në këtë organizim të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, udhëtimi zyrtar i pjesëmarrësve është në këtë përbërje: Adem Morina, drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Sherife Çengaj-zyrtare për promovimin e Turizmit, dhe për të njëjtit lejohet pagesa e mëditjeve konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
 5. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurëve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

